



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT

Kopje 1;

Nr. 1322 Prot

Tiranë më 27/07/2020.

URDHËR

Nr. 60, datë, 27.07.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES

“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E TRUPAVE VLERËSUESE”

Në mbështetje të gërmës “a” të nenit 3 dhe nenit 12 të ligjit nr.70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, nenit 7 të Rregullores së Shërbimit të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.829, datë 03.12.2014, si dhe ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për Organizimin dhe funksionimin e trupave vlerësuese”.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Brendshme.
3. Për kontrollin e zbatimit të këtij Urdhri ngarkohet Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së dhe Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Muhamet RRUMBULLAKU



RREGULLORE

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN

E

TRUPAVE VLERËSESE

*Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit për Çështjet e Brendshme
dhe Ankesat*

Nr. 60 datë 27.07.2020

TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I PARË

Neni 1
Neni 2
Neni 3
Neni 4

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Qëllimi
Objekti
Parimet e veprimtarisë
Përkufizime

KREU I DYTË

Neni 5
Neni 6
Neni 7

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE VLERËSUESE

Drejtuesi i trupave të vlerësimit
Trupat e vlerësimit
Kompetencat e anëtarëve të trupave të vlerësimit

KREU I TRETË

Neni 8
Neni 9
Neni 10
Neni 11
Neni 12

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE TË TRUPAVE VLERËSUESE

Pavarësia e trupave vlerësuese
Procedura e vlerësimit të subjekteve
Rastet e konfliktit të interesit dhe pengesat ligjore
Mbledhja e anëtarëve të trupave të vlerësimit
Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të trupës së vlerësimit

KREU I KATËRT

Neni 13
Neni 14
Neni 15
Neni 16
Neni 17

ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

Procedura e depozitimit të dokumenteve të subjekteve
Procedura e korrespondencës së klasifikuar sekret shtetëror
Veprimet paraprake për shpërndarjen e dokumentacionit të trupa vlerësuese
Bashkëpunimi
Trajnimi

KREU I PESTË

Neni 18
Neni 19
Neni 20
Neni 21

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE

E drejta për t'u njohur me materialet e dosjes
Vendimi përfundimtar i trupës së vlerësimit
E drejta e ankimimit
Njoftimi Vendimit

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe standardeve që do të zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së trupave të vlerësimit në zbatim të ligjit nr.12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

Neni 2 **Objekti**

1. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i:
 - a) rregullave dhe procedurave për vlerësimin kalimtar dhe periodik të subjekteve të vlerësimit;
 - b) rregullave të komunikimit dhe ndërveprimit me strukturat mbështetëse referuar nenit 30 të ligjit nr.12/2018;
 - c) rregullave të bashkëpunimit, ndërveprimit, informimit dhe njoftimit të palëve të treta (institucionet publike dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, media dhe publiku, subjekti i vlerësimit) gjatë zhvillimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve që përcakton ligji nr.12/2018;
2. Për çështje që nuk gjejnë rregullim nga ligji nr.12/2018 apo nga kjo rregullore, Trupat e Vlerësimit i referohen legjislacionit në fuqi sipas natyrës të çështjes.

Neni 3 **Parimet e ushtrimit të funksioneve dhe organizimit të veprimtarisë institucionale**

1. Trupat e vlerësimit e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, ligjin nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", ligjin nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" i ndryshuar, ligjin nr.8480 datë 27.05.1999 "*Për funksionimin e organeve kolegjiale në administratën shtetërore dhe entet publike*", ligjin nr.70/2014 "*Për shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme*", legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, këtë rregullore dhe akte të tjera nënligjore, brenda kompetencave të autorizuara nga ligji dhe në përputhje me qëllimin e ngritjes dhe funksionimit të trupës së vlerësimit.
2. Trupat e vlerësimit kryejnë procesin e vlerësimit duke respektuar parimet e:
 - a) Ligjshmërisë dhe përgjegjësisë;
 - b) Pavarësisë dhe besueshmërisë së procesit;
 - c) Procesit të rregullt ligjor;
 - ç) Proporcionalitetit dhe objektivitetit;
 - d) Paanshmërisë, barazisë dhe efektivitetit;
 - dh) Konfidencialitetit, ruajtjes së sekretit shtetëror dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
 - e) Transparencës dhe të drejtës së informimit.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Punonjës i SHÇBA-së” është personi i emëruar në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të nëpunësve civilë.
2. “Punonjës policie” është personi i emëruar në Policinë e Shtetit, me gradë policore, në përputhje me ligjin për Policinë e Shtetit.
3. “Punonjës i Gardës së Republikës” është personi i emëruar në Gardën e Republikës, me gradë, në përputhje me ligjin për Gardën e Republikës së Shqipërisë.
4. “Subjekt vlerësimi” janë punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, si dhe ish-punonjësit, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 6, pika 5, të ligjit 12/2018.
5. “Grup vlerësimi” është njësia e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj punonjësve që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
6. “Procesi i vlerësimit” përfshin si procesin kalimtar, ashtu dhe procesin periodik të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme.
7. “Partnerë ndërkombëtarë” janë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat organet e vlerësimit konsultohen gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të organeve të vlerësimit dhe vlerësimit kalimtar të punonjësve.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE VLERËSUESE

Neni 5

Drejtuesi i trupave të vlerësimit

1. Vlerësimi kalimtar dhe periodik i subjekteve të përcaktuara në ligjin nr.12/2018 bëhet nga punonjësit e SHÇBA-së, të cilët organizohen në “Trupa vlerësimi” të cilat janë të pavarura në vendimarrje për subjektet e vlerësimit.
2. Trupa e vlerësimit drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.
3. Drejtuesi i trupave të vlerësimit ka përgjegjësi administrative dhe teknike, por nuk përfshihet në vendimarrje për subjektet e vlerësimit. Ai organizon punën dhe ka përgjegjësi për:
 - a) marrjen e masave për sigurimin e kushteve optimale për zhvillimin e veprimtarisë së trupave të vlerësimit;
 - b) marrjen e masave për përcaktimin e trupave të vlerësimit nëpërmjet shortit;
 - c) marrjen e masave për vendosjen dhe sigurimin e bashkëpunimit midis institucioneve për shkëmbim informacioni;
 - ç) funksionimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik;

d) identifikimin e problematikave dhe marrjen e masave si dhe ofrimin e alternativave për zgjidhjen e tyre, përfshirë trajnimin e punonjësve të trupave të vlerësimit;

dh) hartimin e projekt-akteve, programeve, dokumenteve strategjike apo materialeve të nevojshme për garantimin e ushtrimit të veprimtarisë së trupave të vlerësimit;

e) nënshkruan të gjitha aktet me përjashtim të vendimeve për rezultatin e vlerësimit, të cilat nënshkruhen nga trupat e vlerësimit;

ë) informon Drejtorin e Përgjithshëm dhe merr masa për zhvillimin e mbledhjes së anëtarëve të trupave të vlerësimit për çdo lloj vendimmarrje, me kërkesë të jo më pak se 3 anëtarëve që paraqesin një çështje për diskutim;

f) kryen detyra të tjera, të cilat i delegohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe që nuk u ngarkohen anëtarëve apo trupave të vlerësimit.

4. Në mungesë të drejtorit, Drejtori i Përgjithshëm autorizon me shkrim si zëvendësues një punonjës tjetër duke përcaktuar saktësisht afatin e zëvendësimit.

Neni 6

Trupat e vlerësimit

1. Trupë vlerësimi është njësia e vlerësimit e organizuar në formën e organit kolegjial përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj subjektit që do të vlerësohen sipas ligjit nr.12/2018.

2. Për çdo subjekt vlerësimi, caktohet trupa e vlerësimit e përbërë nga 3 punonjës.

3. Çështjet, pasi janë regjistruar, u shpërndahen trupave vlerësuese përmes procedurës së shortit.

4. Nëpërmjet shortit, për çdo subjekt vlerësimi caktohet relatori si dhe kryesuesi i trupës vlerësuese. Procedura e hedhjes së shortit përcaktohet në rregullore të veçantë.

5. Në rast se anëtari i trupës së vlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar me short, për shkaqe të përmendura në nenin 30 të *Kodit të Procedurave Administrative* ose të ligjit nr.9367 datë 7/4/2005 "*Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike*", ai njofton me shkrim menjëherë drejtuesin e trupave të vlerësimit. Përjashtimi i anëtarit të trupës vlerësuese nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trupë që caktohet me short.

6. Kur një anëtar i trupës vlerësuese, për shkaqe objektive nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes dhe në rast se shqyrtimi paraprak nuk mund të shtyhet, ai zëvendësohet nga një anëtar tjetër i trupës i cili caktohet me short.

7. Pas hedhjes së shortit, të dhënat për çështjen, trupën vlerësuese dhe relatorin publikohen.

Neni 7

Kompetencat e anëtarëve të trupave të vlerësimit

1. Anëtarët e trupave të vlerësimit kanë këto kompetenca:

a) ndërmarrin të gjitha iniciativat dhe kryejnë të gjitha procedurat për të garantuar provat, të dhënat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vlerësimit;

b) marrin të gjitha masat dhe hartojnë dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes;

c) kërkojnë informacion shtesë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) thërrasin individët apo persona të tjerë të informuar mbi faktet në seancat dëgjimore;

d) propozojnë dhe marrin vendimin e arsyetuar;

dh) bashkërendojnë punën dhe marrin masa për të garantuar zbardhjen e vendimeve brenda 15 ditëve nga marrja e tyre.

2. Në raste të veçanta, kur kërkohet ekspertizë juridike e financiare, trupa e vlerësimit konsultohet me specialistë të fushave përkatëse të Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të tjera publike ose kontraktin ekspertë të pavarur, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Relatori i trupës së vlerësimit ka këto detyra:

- a) përgatit dosjen që diskutohet nga trupa e vlerësimit;
- b) ndërmerr të gjitha veprimet për të garantuar provat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
- c) merr të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes.

9. Krahas detyrave të veçanta të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.12/2018, anëtari i trupës së vlerësimit duhet gjithashtu:

- a) të punojë me përkushtim dhe frymën e bashkëpunimit, me profesionalizëm, ndershmëri, paanësi dhe efikasitet me qëllim përmbushjen e detyrës në të cilën është emëruar, në përputhje me ligjin Nr. 12/2018 si dhe legjislacionit referues;
- b) të veprojë në përputhje me normat etike të sjelljes, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- c) të paraqitet në detyrë me veshje të përshtatshme dhe serioze, për të përfaqësuar sa më denjësisht institucionin dhe imazhin e tij, si dhe të mbajë vazhdimisht brenda mjediseve funksionale kartën zyrtare të identifikimit me fotografi dhe/ose të dhëna të tjera.

KREU III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE TË TRUPAVE VLERËSUESE

Neni 8

Pavarësia e trupave vlerësuese

1. Trupa vlerësuese është e pavarur në lidhje me vendimmarrjen ndaj subjekteve të caktuara për vlerësim nëpërmjet shortit.

2. Anëtari i trupës së vlerësimit, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për veten apo për një anëtar tjetër të trupës vlerësuese lidhur me një çështje, është i detyruar të deklarojë menjëherë me shkrim natyrën e interesit ose pengesës duke njoftuar trupën vlerësuese. Ai nuk mund të marrë pjesë në diskutimin e çështjes përkatëse dhe as në votimin e saj deri në marrjen e vendimit nga ana e trupës tjetër vlerësuese.

3. Çdo person, i cili është në dijeni të një konflikti interesi ose të një pengese ligjore për një anëtar të trupës vlerësuese lidhur me një çështje, mund të njoftojë trupën vlerësuese me shkrim duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi.

4. Trupa vlerësuese e njoftuar sipas pikës 2 të këtij neni, me marrjen e kërkesës nga njëri prej anëtarëve të tij apo nga çdo person tjetër, sipas pikës 3 të këtij neni, njofton menjëherë Drejtuesin e Trupave të Vlerësimit, dhe ky i fundit Titullarin e Institucionit i cili autorizon organizimin e procedurës së shortit për caktimin e trupës vlerësuese që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin ose jo të anëtarit nga procedura. Rregullat e parashikuara për organizimin e shortit për çështjet zbatohen dhe në këtë rast.

5. Trupa vlerësuese e caktuar me short merr vendim për përjashtimin ose jo të anëtarit të trupës vlerësuese brenda 5 ditëve nga caktimi i çështjes me short.

6. Nëse trupa vlerësuese vendos përjashtimin e anëtarit nga trupa, ai zëvendësohet nga një prej anëtarëve të tjerë të trupave të vlerësimit, me short.

Neni 9

Procedura e vlerësimit të subjekteve

1. Gjatë hetimit administrativ, trupat e vlerësimit mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike apo private, si dhe të asistohen me ekspertizë nga partnerët ndërkombëtarë që asistojnë Ministrinë e Brendshme.

2. Trupat e vlerësimit verifikojnë e vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit dhe marrin në konsideratë, në dhënien e vendimit, bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e punonjësit gjatë procesit të vlerësimit.

3. Trupat e vlerësimit verifikojnë informacionet e vëna në dispozicion nga publiku, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

4. Vlerësimi i subjekteve nga trupa vlerësuese, kryhen sipas procedurave të përcaktuara në kreun VI të ligjit nr.12/2018.

Neni 10

Rastet e konfliktit të interesit dhe pengesat ligjore

1. Anëtari i trupës së vlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje nëse ekziston një nga shkaqet e parashikuara në ligjin nr.9367 datë 07/04//2005 “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar dhe nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Anëtarët e trupave të vlerësimit përpara marrjes së detyrës nënshkruajnë deklaratën sipas nenit 27, pika 1 të ligjit nr.12/2018 si dhe për çdo rast, deklaratën e konfliktit të interesit rast pas rasti sipas rregullores së shortit të miratuar.

3. Për çdo rast, anëtari i trupës zbaton kuadrin ligjor për deklarimin, parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.

4. Modeli i formularit të deklarimit është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje (shtojca1).

Neni 11

Mbledhja e anëtarëve të trupave të vlerësimit

1. Mbledhja e anëtarëve zhvillohet nën drejtimin e drejtuesit të trupave vlerësuese në mënyrë periodike ose kur kërkohet nga anëtarët e trupës vlerësuese apo Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së. Në mbledhjet e anëtarëve të trupave vlerësuese diskutohen çështjet e mëposhtme dhe jo vetëm:

a) propozohen politika të drejtimit dhe funksionimit të trupave të vlerësimit në aspektin administrativ;

b) propozohen dhe hartohen akte nënligjore në zbatim të ligjit Nr.12/2018 ose akteve administrative të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit;

c) detajohet mënyra për lëshimin e kopjeve të dosjes/dokumenteve që palëve iu vihen në dispozicion;

ç) identifikohen dhe propozohen nevojat në vazhdimësi për mbështetje buxhetore dhe logjistike;

d) përgatitet çdo informacion dhe raportim për Drejtorin e Përgjithshëm të SHÇBA-së duhet të kryejë për ecurinë e procesit të vlerësimit.

Neni 12

Përgjegjësia disiplinore e anëtarit të trupës së vlerësimit

1. Anëtarët e Komisionit kanë përgjegjësi disiplinore sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit nr.12/2018, ligjit nr.70/2014 dhe rregullores së shërbimit.

2. Procedimi disiplinor fillon sipas procedurave të nenit 28 të ligjit nr.12/2018 dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e shërbimit.

3. Drejtuesi i trupave të vlerësimit drejton procedurën e shortit. Brenda 48 orëve nga zgjedhja e komisionit ad hoc të përzgjedhur nga shorti me përbërje jo më pak se tre anëtarë, Komisioni disiplinor fillon shqyrtimin paraprak të rastit. Në rast se Komisioni konstaton se kërkesa nuk përbën bazë për fillimin e procedimit, me vendim vendos mosfillimin.

5. Në rast të fillimit të procedimit, zbatohen procedurat e përcaktuara në nenin 28 të ligjit nr. 12/2018, Kodit të Procedurave Administrative dhe rregullores së shërbimit.

KREU IV

ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT

Neni 13

Procedura e depozitimit të dokumenteve të subjekteve

1. Para fillimit të shortimit të subjekteve, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat i kërkon institucioneve përgjegjëse, listën emërore të subjekteve që përcaktohen sipas renditjes së funksioneve në nivel hierarkik.

2. Bazuar në listën e subjekteve sipas depozitimit nga institucionet, hidhet shorti sipas hierarkisë së funksioneve. Pas shortimit të listës së subjekteve, Shërbimi u kërkon institucioneve përgjegjëse dosjet e subjekteve të shortuar.

3. Dorëzimi i dosjes së subjektit të vlerësimit bëhet sipas ligjit nr.12/2018.

4. Për dosjet e depozituara në Shërbim, punonjësi i ngarkuar për administrimin e dokumentacionit:

a) regjistron dhe numërton në regjistrin përkatës;

b) krijon fashikullin e çështjes;

c) merr masa për shpërndarjen e tij sipas rregullave përkatëse.

5. Praktikë shkresore që shërbejnë për vlerësimin e subjekteve nga Trupa e Vlerësimit, administrohen në regjistrat përkatës si më poshtë:

a) Regjistri i përgjithshëm i hyrjes dhe daljes së korrespondencës;

b) Regjistri i përgjithshëm i dosjeve, ku regjistrohen subjektet që i nënshtrohen procesit të vlerësimit ex-officio dhe subjekteve që i nënshtrohen procesit të vlerësimit me kërkesë;

c) Regjistri i vendimeve dhe të cilave u jepet një numër;

ç) Regjistri i akteve të miratuara;

d) Regjistri special i korrespondencës së klasifikuar "sekret shtetëror";

dh) Regjistri i arkivit përfshirë arkivimin e dosjeve të subjekteve dhe ruajtjen e procesverbaleve të seancave dëgjimore (audio dhe të zbardhura tekst);

e) Regjistri i konfliktit të interesit dhe vendimmarrjet përkatëse lidhur me to;

ë) Regjistri për denoncimet e publikut sipas nenit 55 të ligjit nr.12/2018.

Neni 14

Procedura e korrespondencës së klasifikuar sekret shtetëror

1. Anëtarët e trupave të vlerësimit duhet të sigurojnë sekretin e të dhënave dhe konfidencialitetin e procedurave dhe të dokumenteve që administrojnë apo marrin në dijeni.

2. Aktet që konsiderohen dokumente të një rëndësie të veçantë regjistrohen në regjistrin special të korrespondencës sekrete dhe trajtohen sipas rregullave dhe procedurave të menaxhimit të fondit arkivor.

3. Anëtarët e trupës së vlerësimit nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit. (shtojcë2).

4. Punonjësi i protokollit/arkivës ka përgjegjësi për evidentimin, regjistrimin, qarkullimin dhe ruajtjen e dokumentacionit hyrës-dalës si dhe të atij që prodhohet nga brenda institucionit (përfshirë atë publik dhe jopublik, si dhe atë sekret shtetëror), dokumentimin dhe sistemin e tij arkivor pas përfundimit të çështjes apo praktikës përkatëse, si dhe duhet të garantojë sigurinë e ruajtjes së vulave të institucionit bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Veprimet paraprake për shpërndarjen e dokumentacionit të trupave vlerësuese

1. Pas përcaktimit me short të trupës vlerësuese, Relatori merr në dorëzim dosje për shqyrtim.

2. Relatori i çështjes, kryen të gjitha veprimet procedurale si më poshtë:

a) përgatit dosjen që diskutohet nga trupa vlerësuese;

b) ndërmerr të gjitha veprimet për të garantuar provat dhe informacionet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;

c) merr të gjitha masat për të hartuar dokumentacionin e nevojshëm deri në përfundimin e çështjes.

3. Pas plotësimit të dosjes me relacionin e përgatitur nga relatori, kryesuesi i trupës vlerësuese cakton datën e seancës dëgjimore.

Neni 16

Bashkëpunimi

Shërbimi gjatë aktivitetit të tij, bashkëpunon me institucione të tjera gjatë vlerësimit të tre komponentëve, sipas parashikimeve të ligjit nr.12/2018, sipas referencave të neneve 32-47 si dhe neneve 48, 51, 52, 54 dhe nenit 55 të ligjit nr.12/2018.

Neni 17

Trajnimi

Anëtarët e trupave të vlerësimit para fillimit të detyrës i nënshtrohen procesit të trajnimit disa javor sipas përcaktimit të nenit 64 të ligjit nr.12/2018 dhe programit të miratuar.

Gjatë procesit të hetimit administrativ, trupat e vlerësimit mund të kërkojnë ekspertizën e huaj nga misionet që asistojnë Ministrinë e Brendshme.

KREU V

TË DREJTAT E SUBJEKTEVE

Neni 18

E drejta për t'u njohur me materialet e dosjes

1. E drejta e informimit garantohej sipas parashikimeve të ligjit nr.119/2014 "Mbi të drejtën e informimit" dhe mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Në raste të tilla, Shërbimi konsultohet/merr mendim me shkrim nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 4, pika 3, të ligjit nr.12/2018.

2. Raporti i relatorit, projektvendimi, çfarëdo informacioni për diskutimin dhe për votimin e trupës, projektvendimet dhe çfarëdo shënimesh të anëtarëve të trupës gjatë diskutimit dhe gjatë shqyrtimit të rastit, duhet të jenë konfidenciale dhe në të nuk do të kenë akses as palët, e as publiku.

3. Në bazë të kërkesës me shkrim të paraqitur nga çdo subjekt, anëtari i trupës vlerësuese respektive jep informacion në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Data e caktimit për njohjen e dosjes, caktohet si rregull, ditën e enjte, por në varësi të agjendës së punës së trupës vlerësuese.

Neni 19

Vendimi përfundimtar i trupës së vlerësimit

Në përfundim të procesit të vlerësimit të punonjësit, trupa e vlerësimit vendos:

- a) konfirmimin në detyrë;
- b) detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara;
- c) detyrimin e titullarit të institucionit për emërimin në detyrë të ish-punonjësve;
- ç) përjashtimin nga detyra.

Neni 20

E drejta e ankimit

Kundër vendimeve të trupave të vlerësimit mund të ushtrohet ankim i drejtpërdrejtë në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 21

Njoftimi i vendimit

Njoftimi i vendimit të trupës vlerësuese bëhet në zbatim të parashikimeve të nenit 56, pika 8, të ligjit nr.12/2018 si dhe për sa është e nevojshme, Kodit të Procedurave Administrative.